



REPUBLIKA E SHQIPERISË
MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT
AGJENCIA KOMBËTARE E MJEDISIT
DREJTORIA E VLERËSIMIT TË IMPAKTIT DHE LIÇENSIMIT

AN110620210005

Tiranë, më: 15.07.2021

Komisioni 33

DEKLARATË MJEDISORE

Në mbështetje të Ligjit Nr. 12/2015 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 10440, datë: 07.07.2011, “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, VKM Nr. 686, datë 29.7.2015 “Për miratimin e rregullave, të përgjegjësisë e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore” dhe me propozim të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, Ministri

VENDOSI:

Lëshimin e Deklaratës Mjedisore për **Zhvilluesin** me të dhënat si më poshtë:

Personi Juridik: “Pure Albania” Sh.p.k.

Nr. NIPT-i: M12716201A

Adresa e selisë: Rruga Kombinati Metalurgjik, Zona Kadastrale 3965, Nr. Pasurisë 934, Bradashesh, Elbasan.

Personi përgjegjës Mesut Yanar

Për të zhvilluar projektin **“Prodhimi i oksidit të zinkut dhe koncentratit të hekurit nga pluhuri i furrës me hark elektrik.”**

Aplikimi është bërë referuar ligjit Nr. 10 440, date: 7.7.2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, Shtojca I, “Projektet që i nënshtrohen Procedurës së Thelluar të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis”, Pika 19. Gurore dhe miniera sipërfaqësore, ku sipërfaqja e vendit është mbi 0,5 hektarë, ose vende për nxjerrjen e torfës, ku sipërfaqja e vendit është mbi 1 hektar.

Vendndodhja: Zona Kadastrale: 3965, Nr. Pasurisë: 934, Objekt industrial Brenda Ish Kombinatit Metalurgjik, Bashkia Elbasan.

Të dhëna teknike:

Sipërfaqe totale 1 621 m²

Sipërfaqe aktiviteti 1 180 m²

Kapacitet riciklimi prej 6,000 tonë në vit ose 500 tonë/muaj,

(Bashkangjitur vendimit, gjeni aneksin me hartën topografike dhe koordinatat metrike, ku tregohet vendodhja e objektit)

Bazuar në nenin 12, të ligjit nr. 10440, datë 7.7.2011, “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, i ndryshuar, i sugjerohet autoritetit planifikues:

Miratimi i lejes/licencës së zhvillimit të atij projekti, me kushtet që duhet të përmbushen nga zhvilluesi, për të parandaluar, minimizuar dhe menaxhuar ndikimet negative në mjedis;

Bazuar në pikën 2, të nenit 12, të ligjit nr. 10440, datë 7.7.2011, “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, të ndryshuar, më poshtë po listojmë:

1. Qëndrimin e Ministrisë dhe sipas rastit, kushtet që duhet të përmbushen nga zhvilluesi:

Drejtoritë Teknike të Ministrisë shprehen: - Sugjerojmë respektimin e kuadrit ligjor në fuqi, në fushën e mbetjeve si më poshtë vijon:

- Ligji nr. 10 463, datë 22.9. 2011”Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, të ndryshuar ;
- Të respektohen kërkesat e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 418, date 25.06.2014 “Për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim” ;
- Mbetjet që do të krijohen të specifikohen sipas kodeve të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 99, datë 18.02.2005 “Për miratimin e katalogut shqiptar të klasifikimit të mbetjeve” të ndryshuar;
- Transferimi i mbetjeve jo të rrezikshme të shoqërohet me plotësimin e shtojcës 1 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 229, datë 23.04.2014 “Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe të dokumentit të transferimit të mbetjeve jo të rrezikshme”;
- Mbetjet e rrezikshme, të dorëzohen sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 371, datë 11.06.2014 “Për përcaktimin e rregullave për dorëzimin e mbetjeve të rrezikshme dhe miratimin e dokumentit të dorëzimit të mbetjeve të rrezikshme.;
- Subjekti që do të transportojë ose do të transferojë mbetjet të jetë i pajisur me licensë III.2.B , si detyrim i nenit 57, të ligjit nr. 10463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve “ i ndryshuar;
- Mbetjet inerte të gjeneruara të trajtohen sipas kërkesave të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 575, datë 24. 06. 2015 “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte”.

- Sugjerojmë të respektohen kriteret e legjislacionit si më poshtë vijon:

- Ligj nr 68-2014, datë 03.07.2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr 9587, datë 20.7.2006 “Për mbrojtjen e biodiversitetit”, të ndryshuar;
- Ligji nr 81, datë 04.05.2017 “Për Zonat e Mbrojtura”;
- Ligji nr.8294, datë 2.3.1998 “Për ratifikimin e "Konventës për ruajtjen e florës dhe faunës së egër dhe mjedisit natyror të Europës (Konventa e Bërnes)";
- Ligji nr.10 006, datë 23.10.2008 “Për mbrojtjen e faunës së egër”;
- Vendim nr. 303, datë 10.5.2019 “Për miratimin e listës së rishikuar, të përditësuar, të monumenteve të natyrës shqiptare”;
- Rekomandojmë zbatimin me rigorozitet të VKM-së nr. 435, datë 12.9.2002 “Për miratimin e normave të shkarkimeve në ajër në Republikën e Shqipërisë”.
- Të merren masat për shmangien e rrjedhjeve të pakontrolluara të lëngjeve ndotëse (të tilla si karburantet e automjeteve dhe makinerive), derdhje apo shkarkime aksidentale të substancave toksike që priten të vijnë gjatë operacioneve të instalimit të teknologjisë.
- Filtrat e gazeve, të jenë në përputhje me modelin e teknologjisë që do të përdoret për këtë aktivitet.
- Të sigurohet funksionimi dhe mbajtja në punë e filtrave, gjatë gjithë funksionimit të aktivitetit. Në rast avarie, të bëhet zëvendësimi i menjëhershëm i tyre.
- Sugjerojmë që stafi që do të punësohet në këtë aktivitet, të jete i trajnuar në përdorimin e filtrave.

- Gjatë transportit, mjetet transportuese mos të ngarkohen më shumë se kapaciteti i projektuar dhe të mbulohen me mbulesa, për të parandaluar rrjedhjet në rrugë dhe emetimin e pluhurave.
- Rekomandojmë AKM-në, në momentin e lëshimit të Lejes së Mjedisit, për këtë aktivitet, të përcaktojë normat e shkarkimeve në ajër, për ndotësit e caktuar, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e cilësisë së ajrit në mjedis.
- Të shmangen në çdo mënyrë derdhjet aksidentale të oksidit të zinkut apo përbërjeve të tjera në tokë apo në ujë.
- Burimet e të dhënave për mjedisin ekzistues nuk janë referuar si duhet. Kriteret dhe burimet e standardeve të cilësisë, të përdorura në vlerësim, duhet të paraqiteshin në mënyrë të qartë. Nuk janë përshkruar ndikimet kumulative të projektit në mjedis, së bashku me zhvillimet e tjera ekzistuese ose të planifikuara të zonës.
- Masat zbutëse të propozuara për ndikimin në biodiversitet nuk janë të qarta dhe duhet të mbështeten me evidenca për përshtatshmërinë dhe efikasitetin, duke përfshirë ilustrimin e suksesit të tyre dhe efekteve anësore në raste të ngjashme. Do të ishte mirë që angazhimi i qartë i zhvilluesit të projektit për zbatimin e masave zbutëse dhe kompensuese të shprehet sipas afateve kohore dhe kostove përkatëse.
- Për sa i përket parandalimit dhe zvogëlimit të pasojave në mjedis dhe rehabilitimit të mëvonshëm të tij, sugjerojmë:
 - Sigurimin e të gjitha pajisjeve të nevojshme për riparim, pastrim dhe ndërhyrje në raste emergjencash dhe njoftimin e menjëhershëm të autoriteteve dhe njërive të specializuara;
 - Kur është e mundur, nivelet e zhurmës gjatë orëve të agimit, muzgut dhe natës duhet të minimizohen për të zvogëluar shqetësimin, veçanërisht për gjitarët dhe shpendët;
 - Të minimizohet dëmtimi i sipërfaqëve të panevojshme gjatë ndërtimit;
 - Të kryhet rrethimi i kantierit të ndërtimit gjatë punimeve ndërtuese dhe gërmuese;
 - Për mbjellje të përdoren lloje vendase, të përshtatura me kushtet e substratit dhe të klimës në zonë si: Gështenjë e egër (*Aesculus hippocastanum*), Dafinë (*Laurus nobilis*), Butinë (*Viburnum tinus*), Boshtër (*Forsythia europaea*), Leandër (*Nerium oleander*), Ilqe (*Quercus ilex*), Rrënjë (*Quercus robur*), Vidh (*Ulmus glabra*, *U. Minor*), Dëllinjë (*Juniperus sp.*), Shqopë (*Erica arborea*, *E. multiflora*), Lofatë (*Cercis siliquastrum*), Panjë (*Acer hyrcanum*, *A. pseudoplatanus*, *A. monspessulanum*), Fshikarthë (*Colutea arborescens*), Bli (*Tilia sp.*), etj. Drurëve dhe/ose shkurreve të përdorura për rehabilitimin e mjedisit të dëmtuar duhet t'u sigurohet substrati i duhur i tokës dhe kushtet e mjaftueshme për të mbijetuar.
- Duke qënë se zona ku do të zhvillohet aktiviteti është zonë industriale brenda fabrikës së Hekurit Kurum, në ish Kombinatin Metalurgjik, projekti nuk pritet të shkaktojë ndikime negative në pyje, kullota, prerje drurësh apo fragmentarizim habitatesh. Zona në afërsi të ish Kombinatit nuk karakterizohet nga bimësi shkurre apo bimësi e lartë. Ka prani të bimësisë barishtore, e mbirë në një mjedis me përbërje zhavorrishte, të varfër në humus dhe vlera të ulëta ushqyese për bimët.
- Sugjerojmë mbjelljen me filiza bimor vendas të të gjithë periferisë së territorit të përdorur për shfrytëzim. Brezi periferik i bimësisë do të ndikojë pozitivisht në cilësinë e ajrit, në uljen e nivelit të zhurmave dhe për më tepër do të rrisë mundësinë për vetëgjenerim të bimësisë në pjesën tjetër të zonës.
- Duke patur parasysh se ndikimi në ajër i ndotjes akustike për këtë lloj aktiviteti do të jetë i përhershëm, sugjeromëj të zbatohet legjislacioni specifik në lidhje me zhurmat dhe me nivelet kufi të zhurmave.

Agjencia Rajonale e Mjedisit: Subjekti ka paraqitur dokumentacionin përkatës për aplikim. ARM Berat-Korçë-Elbasan në mbështetje të VKM 686 datë 29.07.2015 ka dërguar kërkesë për mendim

pranë NJQV Elbasan, e cila nuk është shprehur për zhvillimin ose jo të këtij projekti (miratim në heshtje). ARM jep mendimin e saj pozitiv në lidhje me praktikën.

2. Informacion për procesin e realizuar të konsultimit me publikun:

Konsultimi me publikun: U krye ne date 28.05.2021,ora 10:30. Morën pjesë përfaqësues nga komuniteti i zonës, dhe nga Agjencia Rajonale e Mjedisit dhe përfaqësues nga studio mjedisore. Nuk pati ndonjë shqetësim nga komuniteti për zhvillimin e këtij aktiviteti. Në takim është prezantuar projekti, janë dëgjuar sugjerimet e pjesëmarrësve, të cilat do të merren parasysh nga ana e investitorëve, gjatë kohës së shfrytëzimit. Nga ana e investitoreve iu sigurova të pranishmeve që do të merren të gjitha masat për eliminimin e ndikimeve negative në mjedis, duke mos cënuar jetën e banorëve.

3. Arsyet dhe konsideratat kryesore, ku është mbështetur mendimi;

Zhvillimi i aktivitetit është në përputhje me:

- **Impianti do të instalohet në një objekt ekzistues brenda kompleksit metalurgjik të Elbasanit, i cili ndodhet në zonën industriale të qytetit.**

4. Përshkrimin, sipas rastit, të masave kryesore që duhen marrë për të shmangur, reduktuar e nëse është e mundur, për të korrigjuar efektet negative të rëndësishme:

- 4.1** Ky objekt të ndërtohet në përputhje të plotë me Planin e Përgjithshëm Vendor dhe Planin e Detajuar Vendor, të miratuar nga organet kompetente (KKT / Bashkia / Njësi Administrative) dhe akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi. Aktiviteti të zhvillohet vetëm brenda sipërfaqes dhe koordinatave të kërkuara në aplikim.
- 4.2** Në rast se gjatë punimeve shfaqen elemente të tillë si: objekte kulti, gjurmë arkeologjike, burime ujore të rëndësishme etj, subjekti të ndërpresë punimet dhe të lajmërojë urgjentisht organet kopetente.
- 4.3** Kjo Deklaratë është e vlefshme pasi subjekti të bëjë heqjen nga Fondi Pyjor, në rast se aktiviteti bie në një të tillë.
- 4.4** Të bëhet kontroll i vazhdueshëm periodik i aparateve matës e sinjalizues, në rast avarish të bëhet riparimi i menjëhershëm i tyre.
- 4.5** Të instalohet impianti i mbrojtjes nga zjarri të Impiantit të prodhimit.
- 4.6** Të realizohet kapja e trajtimi i ujerave të ndotura të aktivitetit si dhe monitorimi i cilësise së tyre para shkarkimit në mjedis;
- 4.7** Subjekti te kujdeset për menaxhimi e mbetjeve te krijuara nga veprimtaria, duke i transportuar në mënyrë të rregullt në vend grumbullimet e caktura nga Njësitë Vendore ose per rehabilitimin e karrieres. .
- 4.8** Të funksionojnë rregullisht të gjithë agregatat teknologjike të mbrojtjes së mjedisit.
- 4.9** Subjekti të realizojë menjëherë çdo ndërhyrje për pastrimin e mjedisit në ndonjë rast derdhje lëndësh ndotëse në mjedis;
- 4.10** Të pastrohet menjëherë cdo rast ndotje e mjedisit brenda dhe jashtë objektit si pasojë e aktivitetit;
- 4.11** Të realizohet lagia e sipërfaqes së kantierit dhe rrugët e brendshme për të evituar ngritjen e pluhurit gjatë levizjes së mjeteve etj.
- 4.12** Të vendoset sinjalistika paralajmëruese përgjatë gjithë rrugës, me qëllim shmangien e aksidenteve njerëzore.
- 4.13** Të ndërtohen kanalet dhe instalime për menaxhimin e ujërave të shiut.
- 4.14** Të instalohet impianti dhe infrastruktura e kapjes dhe trajtimit te ujerave teknologjike me ndertimin e dy ose me shume dampave ;

- 4.15 Të përmbushen normat e lejuara për instalimet që do të vendosen në lidhje me shkarkimet në mjedis (ajër dhe ujë)
- 4.16 Furnizimi me ujë për procesin teknologjik të bëhet me miratimin të organeve kompetente.
- 4.17 Subjekti të beje kujdes me shkarkimet e ujerave. Ndalohet në mënyrë kategorike shkarkimi i tyre në përroit ekzistues pranë objektit.
- 4.18 Furnizimin me energji elektrike të bëhet konform kërkesave e me miratimin të organeve kompetente.
- 4.19 Operacionet për zbatimin e projektit të përdorin infrastrukturën ekzistuese të transportit (rrugën dhe rrjetet ekzistuese).
- 4.20 Niveli i zhurmave gjatë procesit të ndërtimit të jetë brenda normave të lejuara, të punohet në orare kur shqetësimi i banoreve dhe zonave të jetë me ndikim sa më të ulët
- 4.21 Parkimi i mjeteve dhe ruajtja e makinerive të bëhet vetëm brenda sipërfaqes së përcaktuar;
- 4.22 Transporti i materialit inert të bëhet me mjete të pastra sidomos nga balta (të pastrohen gomat para daljes në rrugë të asfaltuar), gjatë transportit mjetet transportuese të mbulohen me mbulesa të cilat parandalojnë rrjedhjet e materialit në rrugë dhe emetimin e pluhrave.
- 4.23 Të bëhet mbjellja e fidanëve përgjatë gjithë territorit të shfrytëzuar dhe veçanërisht në afërsi të objektit, me qëllim minimizimin e ndotjes së mundshme nga funksionimi i aktivitetit.
- 4.24 Të kontrollohen kushtet teknike të mjeteve të punës në mënyrë periodike për të evituar, parandaluar rrjedhjet e lubrifikanteve dhe hidrokarbureve në mjedis emetimin e gazeve dhe zhurmave të tepërta të shkaktuara nga avari teknike të mjeteve.
- 4.25 Në rast aksidentesh ose defektesh teknologjike që shkaktojnë ndotje të mjedisit, subjekti menjëherë duhet të jap informacion në DRM-në e qarkut përkatës dhe AKM, të cilat bëjnë të mundur njoftimin e popullatës që preket nga ky aksident.
- 4.26 Para fillimit të veprimtarisë të trajnohen të gjithë punëtorët e subjektit si dhe të njihen me termat dhe kushtet e sipercituara në Deklaratë.
- 4.27 Kompania duhet të respektojë gjithashtu edhe kushtet e vendosura të raportin e VNM–se që është paraqitur në aplikim si dhe të ketë parasysh ligjin Ligjin Nr. 10 431, datë 9.6.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”
- 4.28 Të zbatohen të gjitha masat parandaluese, për ndotjen e mjedisit, që parashikohen në Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis.
- 4.29 **Duke qënë se gjatë fazës së funksionimit, ky aktivitet do të ketë efekte në mjedis, në bazë të Ligjit nr. 60/2014 datë 19.6.2014, “Për një ndryshim në ligjin nr. 10 448, datë 14.7.2011, “Për Lejet e Mjedisit”, të ndryshuar, Shtojca I, duhet t’i nënshtrohet procedurave për paisje me Leje Mjedisore.**

5. Monitorimi dhe Raportimi

Në bazë të Ligjit Nr. 128/2020 Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 10440, datë: 07.07.2011, “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, të ndryshuar, Neni 25/1 “Monitorimi dhe vlefshmëria”, zhvilluesi ka detyrimet si më poshtë:

- Zhurma dhe Vibracionet

- Të zbatohen nivelet kufi të zhurmës, referuar Udhëzimit Nr. 8, datë 27.11.2007 “Për nivelet kufi të zhurmave në mjedise të caktuara” dhe Ligjit Nr.9774 datë 12.07.2007 “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis”
- Të merren masa për mbrojtjen e punonjësve nga zhurmat.
- Të merren masat për kufizimin e orareve të punës në kantier.
- Operatori duhet të parandalojë gjenerimin e zhurmës impulsive në zonat e ndjeshme ndaj zhurmës, gjatë operimit të instalimeve.

- Vibrimet në vende të ndjeshme nuk duhet të kalojë 10 mm/s (PPV) në çdo kohë.
- Të bëhet monitorimi i zhurmave për mjediset: automjete/kamiona në hyrje të kantierit, kantier ndërtimi dhe mjedisi urban më i afert me kantierin çdo 6 muaj.

Tabela e niveleve kufi:

Mjedisi	Vlera kufi e zhurmës dB(A) Leq, T Ditë	Vlera kufi e zhurmës dB(A) Leq, T Mbrëmje	Raportimi në AKM	Periodiciteti
Automjete/kamiona ne hyrje te kantierit	55	45	17.01.2022	Çdo 6 muaj
Kantier ndertimi	55	45	17.01.2022	Çdo 6 muaj
Mjedisi urban me i afert me kantierin	55	45	17.01.2022	Çdo 6 muaj

- **Shkarkimet në Ajër**

- Të zbatohen nivelet kufi të shkarkimeve në ajër, referuar Ligjit Nr. 162/2014 “Për Mbrojtjen e Cilësisë së Ajrit në Mjedis” dhe VKM Nr. 248, datë: 24.03.2003 “Për Miratimin e Normave të Përkohshme të Shkarkimeve në Ajër dhe Zbatimin e tyre”.
- Shkarkimet në ajër të jene brenda normave të lejuara, duke marre masa për reduktimin e tyre.
- Kantieri në të cilin emetohen lëndë grimcore në ajër, duhet të pajiset sipas mundësive teknike dhe mbi bazën e natyrës së procesit, me rrjeta uji / sisteme spërkatje / sisteme heqje pluhurash.
- Të bëhet monitorimi i nivelit të pluhurave në ajër, për mjediset: kantier ndërtimi dhe mjedisi urban më i afert me kantierin çdo 6 muaj.

Tabela e niveleve kufi

Ndotësi	Përqëndrimi	Raportimi në AKM	Periodiciteti
Lënda grimcore (PM _{2.5})	20-25 µg/m ³	17.01.2022	Çdo 6 muaj
PM ₁₀	50 µg/m ³ , 40 µg/m ³	17.01.2022	Çdo 6 muaj

- **Cilësia e ujrave**

Parametrat që duhet të monitorohen

Ndotësi	Përqëndrimi	Raportimi në AKM	Periodiciteti
Lëndët në pezulli	50 mg/l	17.01.2022	Çdo 6 muaj

- **Subjekti duhet të sjellë pranë AKM-së si më poshtë:**

- Informacion në momentin e fillimit të punimeve
- Raportimin periodik për parametrat që do të monitorohen sipas datës së raportimit/ çdo 6 muaj.
- Informacion në përfundim të punimeve, lidhur me punimet rehabilituese të territorit përreth, shoqëruar edhe me foto.

- **Afati i Vlefshmërisë**

- Vendimi për VNM-në paraprake për projektin e propozuar është e vlefshme për aq kohë sa është i vlefshëm edhe dokumenti i miratimit të zhvillimit për projektin.

- Nëse projekti, që i është nënshtruar procesit të VNM-së, nuk fillon zbatimin në terren brenda 2 vjetëve nga data e miratimit të deklaratës mjedisore apo të vendimit për VNM-në paraprake, atëherë këto dokumente konsiderohen të pavlefshme dhe procesi i VNM-së fillon nga e para.

Në bazë të udhëzimit të MM dhe MF nr. 7938, datë 17.7.2014 “Për përcaktimin e tarifave dhe vlerave përkatëse për shërbimet që kryen Ministria e Mjedisit për procesin e VNM-së”, ky subjekt ka kryer pagesën 50.000 lekë.

DREJTORI I PËRGJITHSHËM I AKM

EDISON KONOMI

MINISTRI

BLENDI KLOSI

Konceptoi:

Miratoi:

Aneksi 1. Planvendosja e aktivitetit me koordinatat



Tabela 1: Koordinatat e instalimit

Pika	Koordinata X	Koordinata Y
0	4418257	4551162
1	4418231	4551150
2	4418214	4551188
3	4418201	4551230
4	4418210	4551234
5	4418229	4551195
6	4418240	4551199
7	4418219	4551190